



# 2020

Buxheti

për qytetarin



REPUBLIKA E SHqipëRISE  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË



# Shënim

---

Ky material mbështetet në Projektligjin për Buxhetin e Viti 2020 të propozuar me Vendim të Këshillit të Ministrave në nëntor 2018. Ky material paraqet një variant të përmbledhur dhe jo shterues të propozimit të buxhetit 2020.

## Përdorimi i tekstit

Përdorimi i tekstit dhe të dhënave të paraqitura në këtë material, me kusht që të referohen pa ndryshim, lejohet me citimin e burimit:

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

## Modifikimi i tekstit

Në rast se teksti, të dhënat apo grafikët e paraqitur këtu përdoren për të gjeneruar materiale apo të dhëna të ndryshme, preferohet citimi:

Bazohet në të dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

## Informacione të tjera

Projektligji i plotë për Buxhetin 2020 dhe tabelat përkatëse janë botuar në faqen e internetit të Ministrisë së Financave:



[www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al)

Për informacione apo sqarime të nevojshme mund të drejtoheni në adresen:

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit  
Ministria e Financave dhe Ekonomisë  
Blv. Dëshmorët e Kombit, Tiranë

e-mail: [konsultimepba@financa.gov.al](mailto:konsultimepba@financa.gov.al)

Paraqitja grafike nga Grid Cartels.

Botimi i këtij dokumenti u mundësua me mbështetjen e Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore (UN Women). Pikëpamjet e shprehura në këtë publikimin nuk përfaqësojnë detyrimisht pikëpamjet e UN Women.

# Përmbajtja

<b>Mesazh për lexuesin</b>	<b>4</b>
<b>Ekonomi më e fortë</b>	<b>6</b>
Tregues Pozitivë Makroekonomikë	7
Perspektiva ekonomike	8
Punësimi është në rritje	8
<b>1.KONSOLIDIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE THEMELORE</b>	<b>10</b>
1.1 Shëndet për të gjithë	10
1.2 Çdo vajzë dhe djalë në shkollë	12
1.3 Mbrojtje sociale për çdo burrë dhe grua në nevojë	14
1.4 Siguri dhe drejtësi për burrat dhe gratë	16
<b>2.NXISIM ZHVILLIMIN EKONOMIK DHE MBËSHTESIM RAJONET</b>	<b>18</b>
2.1 Ndërtojmë Shqipërinë	18
2.2 Mbështesim ekonominë rurale	21
2.3 Zhvillimi ekonomik	23
<b>3.NGA VIJNË PARATË E BUXHETIT?</b>	<b>24</b>

# MESAZH PËR LEXUESIN



## Zj. Anila Denaj

Ministre e Financave  
dhe Ekonomisë

Ky buxhet për qytetarët përmban një përshkrim të thjeshtuar të propozimit të buxhetit të shtetit për vitin 2020.

Buxheti 2020 mbështet konsolidimin e mëtejshëm të reformave të ndërmarra që promovojnë rritjen ekonomike, punësimin, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve, burrave dhe grave dhe procesin e integritimit në Bashkimin Europian. Ai bazohet në një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist. Politika fiskale do të vijojë të orientohet

drejt konsolidimit fiskal për të vijuar **trajktoren rënëse të raportit të borxhit publik ndaj PBB**. Ky objektivi i politikës fiskale është tejet i rëndësishëm për të siguruar ambientin makroekonomik për një **rritje të qëndrueshme ekonomike mbi nivelin prej 4.1%**, dhe rritjen e punësimin. Rritja ekonomike dhe punësimi, do të mbështetet edhe nga objektivi tjetër i planifikuar në këtë buxhet, ai i sigurimit të një niveli të lartë të **investimeve publike prej 4.7% e PBB-së**.

**Buxheti 2020, planifikon më shumë burime si rezultat i politikave fiskale** të cilat do të vazhdojnë të bazohen në taksimin e ndershëm dhe në nxitjen e investimeve private strategjike në sektorët prioritarë. Ky program bazohet në hartimin e një strategji afatmesme fiskale, përmirësimin e administrimit tatimor dhe ligjin e fiskalizmit si

dhe përmirësime të pritshme të procedurave tatimore për të adresuar problematika të dala gjatë zbatimit.

**Shpenzimet buxhetore për periudhën 2020-2022** do të vijonë të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike, për të konsoliduar rritjen ekonomike nëpërmjet financimit të projekteve të rëndësishme strategjike. Shpenzimet e planifikuara synojnë përfundimin e projekteve infrastrukturore të rrugëve kombëtare, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe bujqësisë. Rijetëzimi rural do të vazhdojë të jetë fokusi kryesor i mbështetjes së qeverisë për këtë mandat, ku programi 100 Fshatrat do të ketë rolin kryesor. Ky buxhet është një pasqyrim i përpjekjeve dhe angazhimeve konkrete të Qeverisë për të adresuar problemet e pabarazive gjinore në të gjithë sektorët. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor, i integruar në të gjitha fazat e buxhetit publik, vijon të jetë për të katërtin vit radhazi një pjesë shumë e rëndësishme e integritimit gjinor, jo vetëm në politika, por edhe në buxhetet që i përkthejnë ato në masa konkrete.

Buxheti 2020, i përgjigjshëm ndaj

nevojave të burrave dhe grave, synon avancimin e përpjekjeve europiane për barazi gjinore, nëpërmjet planifikimit të fondeve buxhetore në vlerën prej 7.2% të fondeve buxhetore, të cilat adresojnë problematika të pabarazive gjinore në sektorë si: shëndetësia, mbrojtja sociale, arsimit, bujqësia, etj. Politikat sociale mbeten sërish në vëmendjen e qeverisë në këtë buxhet, duke rritur shkallën e mbulimit me kontributet e pensioneve si dhe me mbështetjen për familjet, burrat dhe gratë, me politikën e **shpërblimit për çdo lindje**. Do të vijojë financimi i **ngritjes së shërbimeve shoqërore** për burrat dhe gratë me aftësi të kufizuar dhe gjithë burrat e gratë, familjet në nevojë, krahas skemave të pagesave të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.

Përmirësimi i shërbimeve publike, rritja e aksesit, thjeshtimi i procedurave administrative për sipërmarrjen dhe qytetarët burra e gra, rritja e mirëqenies, ulja e borxhit publik dhe mirëmenaxhimi i financave publike përbëjnë platformën e garantuar nga ky buxhet, mbi të cilën mbështetet aspirata europiane e qytetarëve, burra dhe gra, shqiptarë.

# EKONOMI MË E FORTË:

Ekonomia shqiptare vijon rritjen me ritme më të larta se mesatarja e rajonit për të katërtin vit radhazi

Ekonomia shqiptare vijon rritjen me ritme më të larta se mesatarja e rajonit për të pestin vit radhazi. Me planin ekonomik të qeverisë po krijohen vende të reja pune, po rriten investimet dhe financat publike po konsolidohen – duke krijuar mundësi të garantojmë shërbimet publike themelore për të cilat kanë nevojë qytetarët, burrat dhe gratë, familjet e tyre.

Ky buxhet mbështetet mbi perspektivën afatgjatë të ekonomisë, që të sigurojë se përfitimet nga rritja më e madhe ekonomike do të ruhen dhe do të kenë efekt mbi të gjithë burrat dhe gratë në Shqipëri.

Në bazë të këtij plani do të vijojë përmirësimi i sistemit të administrimit tatimor për të nxitur dhe për të shpërblyer burrat dhe gratë që punojnë, për të mbështetur bizneset që të investojnë dhe të krijojnë më shumë vende pune. Buxheti 2020 vijon të garantojë më shumë punësim – 35 mijë vende të reja pune, politika nxitëse fiskale dhe skema më gjithëpërfshirëse për mbështetjen e punësimit dhe aftësimin profesional të burrave e grave, të rinjve e të rejave.

Mbështesim biznesin për të nxitur investimet dhe krijuar vende të reja pune për burrat dhe gratë në Shqipëri.

Ky buxhet garanton ekonomi më të shëndoshë, rritje të qëndrueshme të vendeve të punës dhe vijueshmëri të investimeve publike.



### PËRPARËSITË TONA:

#### **Buxheti 2020 investon burime në rritje në përparësitë kyç të qeverisë.**

- ◇ Konsolidimi i shërbimeve jetike: shëndetësia, arsimi dhe aksesimi në drejtësi
- ◇ Nxitje e zhvillimit ekonomik dhe mbështetje për rajonet: programe të zhvillimit ekonomik rajonal e rural
- ◇ Ndërtimi i infrastrukturës moderne: Infrastruktura rrugore, e ujit, e turizmit dhe mjedisit
- ◇ Politika sociale: shërbime shoqërore për burrat dhe gratë në nevojë dhe mbështetje për familjet e reja

## TREGUES POZITIVË MAKROEKONOMIKË:

Prodhimi i brendshëm bruto (PBB)


**1793**  
miliardë lekë

Rritja reale

**4,1%**  
PBB

Inflacioni

**2.1%**



## Të ardhurat dhe shpenzimet:

Buxheti 2020 ul deficitin fiskal për të katërtin vit radhazi, në nivelin më të ulët të synuar përgjatë dy dekadave të fundit. Borxhi publik vijon trajktoren rënëse prej katër vjetësh, në nivelin 62,2% të PBB-së.

Të ardhurat

**502,7**  
miliardë lekë

Deficiti Buxhetor

**29,3**  
miliardë lekë

Shpenzimet

**531,9**  
miliardë lekë

OSE  
**1,6%**  
PBB


## PERSPEKTIVA EKONOMIKE

Rritja ekonomike parashikohet të jetë mbi 4.1% në periudhën afatmesme. Ekonomia shqiptare parashikohet të rritet me ritme më të larta se mesatarja e rritjes së vendeve të rajonit.


## PUNËSIMI ËSHTË NË RRITJE

Rritja domethënëse ekonomike e parashikuar për vitin 2020 krijon më shumë punësim me hapjen e mbi 35 mijë vendeve të reja të punës, duke rezultuar në rënien e nivelit të papunësisë në 10.6% në 2020-ën krahasuar me 11.4 % mesatarisht në 2019-ën.

## Rritja ekonomike



## Norma e papunësisë në rënie



Buxheti 2019 vijon të mbështesë krijimin e vendeve të reja të punës me politika incentive fiskale si dhe me një skemë më efektive të punësimit dhe aftësisimit profesional me vëmendje të veçantë për të rinjtë dhe personat me aftësi ndryshe.

## 820 mijë

burra dhe gra, ose 5.1% më shumë punëmarrës se në 2019-ën kontribuojnë në skemën e sigurimeve shoqërore – ulja e informalitetit në punësimin garanton edhe kushte më të mira pune për burrat dhe gratë.

## 1. KONSOLIDIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE THEMELORE:

**Mbështesim më shumë mundësi për një jetë më të mirë** - Buxheti 2020 investon për të siguruar akses në shërbime publike cilësore dhe transparente për të gjithë burrat dhe gratë:



## SHËNDET PËR TË GJITHË

**Buxheti 2020 vijon politikat për mbulimin universal me shërbim cilësor, diagnostikimin dhe parandalimin e hershëm të sëmundjeve dhe shtimin e gamës së medikamenteve të rimbursueshme. Investimet në infrastrukturën shëndetësore për të siguruar aksesin e burrave dhe grave në shërbime themelore ku dhe kur t'u nevojitet janë prioritare:**

**SHËNDETËSIA** : mbi 2% e PBB-së

### **E gjithë vëmendja për burrat dhe gratë:**

- ◇ Shërbimi i kontrollit bazë (check-up) falas për 475 mijë pacientë në vit, 50% burra e 50% gra
- ◇ Mbi 45% më shumë gra mbi 35 vjeç që përfitojnë nga shërbimet falas të depistimit të kancerit të gjirit
- ◇ Depistimi i kancerit të qafës së mitrës ofrohet për herë të parë

për rreth 18.000 gra shërbimi për depistimin e kancerit të qafës së mitrës, duke synuar rritjen në 50% të numrit të grave të depistuar për vitin 2020 dhe uljen e vdekshmërisë nga kjo sëmundje në të ardhmen.

- ◇ Përmirësimi i ofrimit të shërbimit shëndetësor parësor në konsultoret e gruas dhe fëmijës, duke ofruar shërbim cilësor dhe gjithëpërfshirës për më shumë se 50% të nënave të reja dhe mbi 80% të foshnjave vajza e djem
- ◇ Trajtimi me recetë rimbursimi për mbi 475 mijë pacientë burra dhe gra çdo vit përgjatë 2020-2022

### **Rritja e numrit të pacientëve burra dhe gra të trajtuar:**

- ◇ nga 6.4 milionë në 6.7 milionë vizita në kujdesin parësor deri më 2021
- ◇ nga 290 mijë më 2019, në 330 mijë pacientë burra dhe gra të trajtuar çdo vit deri më 2022
- ◇ Depistimi neonatal i dëgjimit për 14 fëmijë të porsalindur përgjatë 2020-2022.
- ◇ 200 pacientë burra dhe gra më shumë që përfitojnë nga paketat e

kardiokirurgjisë

- ◇ Nga 170 mijë seanca dialize në 2019, në 234 mijë në vitin 2022
- ◇ Infrastruktura shëndetësore më e mirë në çdo skaj të vendit:
  - Rikonstruksioni dhe pajisja e plotë e 120 qendrave shëndetësore
  - Rikonstruksioni i godinave spitalore dhe pajisje mjekësore spitalore në qytete të Shqipërisë për mbi 3 miliardë lekë
  - Shtimi i flotës së autoambulancave me 100 copë për periudhën 2020-2021, me një vlerë të përllogaritur rreth 474 milion lekë.

### **Sigurime shëndetësore:**

- ◇ 44,1 miliardë lekë, ose 2,5% e PBB nga 41,9 miliardë lekë në 2019
- ◇ Shtimi i gamës së medikamenteve që trajtohen me recetë rimbursimi



# ÇDO VAJZË DHE DJALË NË SHKOLLË:

**Buxheti 2020 i jep vëmendje të veçantë kërkesës në rritje për arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për djemtë dhe vajzat, zhvillimit të hershëm të tyre; rrit financimet për arsimin parashkollor në dispozicion të bashkive për të mundësuar e uljen e numrit të vajzave dhe djemve në kopshte e shkolla e në mënyrë të spikatur i kushton vëmendje arsimit universitar, në kuadër të Paktit për Universitetin.**

**ARSIMI** : mbi 3% e PBB-së

Mbështetje për familjet në nevojë me sigurimin e transportit për më shumë vajza dhe djem, mësues burra dhe gra, programe të veçanta si ai i shkollave komunitare dhe kujdes për vajzat dhe djemtë me nevoja të veçanta nëpërmjet aksesit më të mirë e rritjes së numrit të mësuesve ndihmës. Buxheti investon në shkolla të reja, ngritjen profesionale të mësuesve burra dhe gra, rritjen e cilësisë së teksteve shkollore dhe sigurimin e teksteve falas për të gjithë vajzat dhe djemtë në arsimin fillor.

## **Nxënie gjithëpërfshirëse dhe cilësore në arsimin parauniversitar**

- ◇ Ndërtime të reja, apo rikonstruksione për mbi 180 objekte arsimore, ose rreth 1800-2000 klasa / laboratorë mësimore në arsimin parauniversitar
- ◇ Transport i 28-30 mijë nxënësve djem dhe vajza që kanë vendbanim mbi 2 km nga shkolla si dhe transportin e 10 mijë mësuesve burra dhe gra që punojnë mbi 5 Km


- nga vendbanimi
  - ◇ Blerje e teksteve shkollore për rreth 240 mijë djem dhe vajza të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë;
  - ◇ 1300-1400 nxënës djem dhe vajza të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë me kuotë ushqimore;
  - ◇ Rritje e numrit të vajzave që regjistrohen në arsimin e mesëm të lartë publik, pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm
  - ◇ Edukimin nëpërmjet sportit në shkolla, për përmirësimin e shëndetit e të mirëqenies për të rinjtë vajza dhe djem
  - ◇ Uljen e madhësisë së grupeve/ klasave të fëmijëve në kopshte nga raporti aktual mesatar 18 fëmijë për një edukatore në raportin 15 fëmijë për një edukatore.
- vitin 2019;
  - ◇ Rritja e numrit të të diplomuarve në shkollat e mesme profesionale, nga 3.300 nxënës në 2019, në 3.600 nxënës në vitin 2022;

### **Arsimi i lartë:**

- ◇ Fondet publike për institucionet e arsimit të lartë do të arrijnë në 2% ndaj PBB në vitin 2022;
- ◇ 100% e studentëve ekselente, studentë në nevojë përfitojnë bursa e kredi studentore deri në 2022;
- ◇ Rritja e mobilitetit të stafit dhe studentëve me 20% në 2020 dhe 40% në 2022 dhe 60% në vitin 2025;
- ◇ Përmirësimi i infrastrukturës dhe arritja e standardeve për çdo program studimi.

### **Arsimi i mesëm profesional:**

- ◇ Rritja e numrit të të punësuarve pas diplomimit në shkollat e mesme profesionale në 46% të totalit që mbarojnë studimet në vitin 2022, krahasuar me 42% në



# MBROJTJE SOCIALE PËR ÇDO BURRË DHE GRUA NË NEVOJË

**Buxheti 2020 mbështet burrat dhe gratë dhe familjet në nevojë nëpërmjet shënjestrimit më të mirë të sistemit të ndihmës ekonomike, aftësisë së kufizuar dhe veçanërisht fokus në ndërtimin dhe zgjerimin e rrjetit të shërbimeve shoqërore në mbarë vendin.**

## PAKETA SOCIALE

Krijimi i fondit social synon mbështetjen e njësisë të qeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve sociale për burrat dhe gratë e grupeve në nevojë dhe mbështetjen e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike me paketa sociale shëndetësore. Programet e riintegritimit social do të synojnë mbështetja e personave nga grupet e pafavorizuara përmes punësimit në ndërmarrjet sociale.

### **Mbështetje për punësim dhe shërbime sociale:**

- ◇ Skema e re e vlerësimit dhe programet e ri-integritimit social mbështesin rreth 3000 familje dhe burra e gra në nevojë që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike deri në vitin 2022, nga ku mbi 12% të përfituesve janë gra kryefamiljare
- ◇ Numri i burrave dhe grave me aftësi të kufizuar si dhe kujdestarëve të tyre do të rritet nga 163 mijë në 171 mijë në vitin 2022, 39% e të cilëve janë gra dhe



vajza me aftësi të kufizuara

- ◇ Rritjen mbi 80% të numrit të përfituesve burra e gra të varfër që marrin NE mbi totalin e aplikuesve.
- ◇ Shtimin e numrit të burrave dhe grave dhe familjeve rome e egjiptiane që përfitojnë nga skema, nga 2640 në 2019 deri në 2800 në 2020 e në vijim,
- ◇ Rritja mbi 60% e numrit të grave dhe vajzave në nevojë të reintegruara pas trajtimit në institucionet e përkujdesit social

### **Mbështesim familjet e reja dhe burrat e gratë në nevojë:**

- ◇ Shpërblimi në lindje: 2 miliardë lekë për shpërblimin për çdo lindje, për të mbështetur rreth 30 mijë familje/ prindër burra dhe gra, në vit
- ◇ Pagesat e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar: 21 miliardë lekë në vit
- ◇ Pagesat e papunësisë dhe mbështetjet për punësim: mbi 1 miliard lekë në vit
- ◇ 1 miliard lekë për ish-të përndjekurit burra dhe gra;

# SIGURI DHE DREJTËSI PËR BURRAT DHE GRATË

**Buxheti 2020 mbështet burrat dhe gratë dhe familjet në nevojë nëpërmjet shënjestrimit më të mirë të sistemit të ndihmës ekonomike, aftësisë së kufizuar dhe veçanërisht fokus në ndërtimin dhe zgjerimin e rrjetit të shërbimeve shoqërore në mbarë vendin.**

## DREJTËSIA DHE RENDI

Garantimi i sigurisë së jetës, shëndetit dhe pronës së burrave dhe grave, djemve dhe vajzave, janë prioritete për veprimtarinë e Policisë së Shtetit, duke përmirësuar kontrollin e territorit dhe policimin në komunitet, parandalimin dhe luftën ndaj dhunës me bazë gjinore, në funksion të një kontrolli më efektiv dhe transformimin rrënjësor të

marrëdhënieve dhe shërbimit ndaj komunitetit.

### **Drejtësi për ish-pronarët burra dhe gra dhe zgjidhje e problemeve sociale:**

- ◇ Sigurimi i një numri praktikash legalizimi pasurish informale prej 25,000 raste në vit;
- ◇ Realizimi i skemës së shpërndarjes

së Fondit Special të Kompensimit në 99% në 2021;

### **4,5 miliardë lekë, ose 0,3% e PBB-së për Fondin për Kompensimin në Vlerë të Pronarëve burra dhe gra**

i cili rritet çdo vit nga 1,89 miliardë lekë që ishte më 2013

### **Siguri në rrugë dhe shërbim policor miqësor:**


- ◇ Përmirësimi i sistemit të kontrollit rrugor, duke synuar krijimin e një kulture të re në qarkullimin e mjeteve dhe të burrave e grave, sidomos në menaxhimin e sigurisë rrugore. Synohet ulja e numrit të aksidenteve në rrugë në masën 1% çdo vit, nga 1936 raste që parashikohen në vitin 2019;
- ◇ Rritjes së nivelit të sigurisë publike duke forcuar kontrollin e territorit dhe policimin në komunitet përmes rritjes së numrit të shërbimeve të patrullimit
- ◇ Reduktimi i kohës së reagimit të shërbimeve policore (nga 20 minuta në vitin 2019 në 13 minuta në vitin

2022).

- ◇ Shtimin e numrit të grave dhe vajzave të diplomuara në Akademinë e Policisë deri në 41% ndaj totalit në vitin 2022, me qëllim realizimin e barazisë gjinore edhe në forcat e Policisë

### **Vëmendje për gratë dhe familjet:**

- ◇ Reduktimi i kohës së reagimit ndaj krimeve të dhunës në familje nga 18 min në 2019 në 14 minuta në 2020
- ◇ Rritja e numrit të masave të menjëhershme mbrojtëse për gratë dhe vajzat e dhunuara në masën 10%.



## 2. NXISIM ZHVILLIMIN EKONOMIK DHE MBËSHTETJEN RAJONET:

Buxheti 2020 investon në zhvillimin ekonomik dhe produktivitetin, me fokus në mbështetjen e ekonomive rurale dhe rajonale.



## NDËRTOJMË SHOIPËRINË


Ndërtojmë akse jetike për burrat dhe gratë dhe biznesin, sigurojmë infrastrukturë ujore për burrat dhe gratë dhe turizmin

### INFRASTRUKTURA DHE PRODUKTIVITETI

Buxheti 2020 investon në infrastrukturën e nevojshme për të rritur zhvillimin ekonomik. Ky buxhet garanton 19 miliardë

lekë investime për projekte të rëndësishme të transportit rrugor në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve në të gjithë vendin:

## TRANSPORTI DHE AKSESI



### 602 kilometra

të ndërtuara, rehabilituara, sistemuara, asfaltuara dhe të pajisura me sinjalistikë rrugore nga 308 km në 2019

### 3.4 miliardë lekë

nga buxheti dhe Banka Botërore për rritjen e cilësisë dhe sigurisë në lëvizje

### Rritja e sigurisë rrugore

në të gjitha akset kombëtare ku synohet ulja e numrit të aksidenteve me pasojë humbje jetë burrash dhe grash, djem dhe vajzash dhe numri i pikave të zeza me

**23%**, sipas Strategjisë Kombëtare të Transportit.

## UJË PËR BURRAT DHE GRATË:

**Reforma në sektorin e ujit vijon të jetë një nga prioritetet e Qeverisë. Ajo mbështetet në reformimin e mirëqeverisjes dhe orientimin e investimeve drejt performancës, si dhe drejt sigurimit të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë, duke sjellë kështu një përmirësim të ndjeshëm dhe të shumëpritur të jetesës së burra dhe grave, djemve dhe vajzave, sidomos në zonat rurale:**

- ◇ Mesatarja e orëve të furnizimit me ujë të pijshëm në rang kombëtar rritet në 14 orë në ditë në 2022, nga 12.5 orë në ditë në vitin 2019;
- ◇ Reduktimi i humbjeve në nivel kombëtar në masën 50% në vitin 2022;
- ◇ Furnizimi me ujë dhe shërbime i zonës bregdetare 24 orë në vitin 2022;
- ◇ Mbi 5,5 miliardë lekë investime në infrastrukturën bashkiake të ujit dhe kanalizimeve në gjithë vendin
- ◇ Projekte për rijetësimin e sistemit të furnizimit me ujë për Durrësin dhe Tiranën

14  
orë

furnizim me  
ujë të pijshëm

24  
orë

furnizimi me ujë  
dhe shërbime i  
zonës bregdetare

Mbi 5,5  
miliardë

lekë investime në  
infrastrukturën bashkiake  
të ujit dhe kanalizimeve

# MBËSHTESIM EKONOMINË RURALE

Krijojmë vende pune dhe perspektivë për burrat dhe gratë, djemtë dhe vajzat

## BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

**Buxheti 2020 vijon të** mbështesë modernizimin e sektorit të bujqësisë nëpërmjet fondeve IPARD; garantimin e sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve dhe shëndetit të bimëve përmes adoptimit të standardeve të BE-së në kuadrin normativ vendas; nxitjen e tregut të tokës dhe konsolidimi i fermës bujqësore duke rritur sipërfaqen dhe nxitur bashkëpunimin; mbështetje për agroindustrinë; dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe blegtorale.

### Zgjerim dhe modernizim i infrastrukturës së ujitje- kullimit:

- ◇ Rritja e sipërfaqes së tokës bujqësore së ujitur nga 66.6% në 72% të totalit potencial prej 360

- mijë hektarë tokë në vitin 2022;
- ◇ Rritja e % së fermerëve që përfitojnë nga përmirësimi i infrastrukturës ujitëse dhe kulluese ndaj totalit të fermerëve në sipërfaqen potencialisht të ujitshme nga 70.3% në vitin 2019, në 76% në vitin 2022;
- ◇ Vepra të mbrojtjes nga përmbytja të rehabilituara/ndërtuara (argjinatura gjatësore dhe penele tërthorë), kundrejt totalit të nevojshëm (300 km) nga 12% në vitin 2019, në 28% në vitin 2022.
- ◇ Rehabilitimi/ndërtimi i rreth 48 km argjinatura të mbrojtjes nga përmbytja dhe erozioni dhe mirëmbajtje vjetore të rrjetit kullues për 45 000 hektarë tokë si proces ciklik vjetor deri në 2022;

## Zhvillimi rural:

Rritja e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore dhe blegtorale dhe përmirësimi i standardeve dhe garantimi i sigurisë ushqimore

- ◇ Vaksinimi i rreth 930 mijë kafshëve përgjatë viteve 2020-2022.
- ◇ Punësimit në çdo qendër administrative e një veterineri zyrtar me qëllim që të rritet kontrolli dhe fusha e mbulimit të vendit me mjekë veterinerë
- ◇ Rritja e numrit të certifikatave të unifikuara për eksport nga 18 në vitin 2019, në 40 në vitin 2022 dhe rritja e numrit të operatorëve në përputhje me standardin HACCP
- ◇ Certifikimit dhe testimit të farave dhe fidanëve që hidhen në treg në mënyrë që të sigurohen inpute cilësore për bujqësinë

## Vijon mbështetja përmes skemave të zhvillimit rural për burrat dhe gratë fermere:

- ◇ 1,2 miliardë lekë mbështetje e drejtpërdrejtë e buxhetit për burrat dhe gratë fermerë, duke rritur numrin e përfituesve nga 1800 përfitues në vitin 2019 në 2450 përfitues në vitin 2022;
- ◇ Deri në 2.5 miliardë lekë mbështetje dhe investime direkte për burra dhe gratë fermerë nga skemat e mbështetjes nga fonde të Bashkimit Europian
- ◇ Rritje të numrit të grave fermere përfituese nga skemat e mbështetjes, duke siguruar edhe informimin dhe këshillimin e tyre me aktivitete të dedikuara



**930 mijë kafshë të vaksinuara**



**Rritja e numrit të certifikatave të unifikuara për eksport**



**Rritja e mbështetjes financiare për fermerët**

# ZHVILLIMI EKONOMIK

## **Buxheti 2020 përqendrohet edhe në promovimin e Shqipërisë si destinacion investimesh, rritjen e konkurrueshmërisë së bizneseve shqiptare në tregun ndërkombëtar nëpërmjet granteve nga:**

- ◇ Fondi i Konkurrueshmërisë (60 biznese të mbështetura financiarisht në 2020-2022, nga ku 20% të përfituesve janë gra sipërmarrëse);
- ◇ Avancimi i mëtejshëm në fushën e teknologjisë dhe inovacionit nëpërmjet granteve që i akordohen bizneseve të specializuara në këtë fushë nga Fondi i Inovacionit (75 biznese të mbështetura financiarisht në 2020-2022, nga ku 40% të përfituesve janë gra);
- ◇ Nxitja e krijimit të bizneseve të reja në sektorë me potencial zhvillimi nëpërmjet Fondit Start-Up (60 biznese të mbështetura financiarisht në 2020-2022, 80% të të përfituesve janë gra);
- ◇ Mbështetja e sipërmarrjeve të sektorit të artizanatit dhe zejtarisë me qëllim konsolidimin e tyre në treg dhe rritjen e numrit të të punësuarëve nëpërmjet "Fondit në mbështetje të biznesit kreativ", ku në total parashikohet të përfitojnë 85 SME vendase me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë (60 biznese të mbështetura financiarisht në 2020-2022, 90% e të cilëve janë biznese të zotëruara nga gratë).
- ◇ Sigurimi i zbatimit efektiv të masave të "gjelbra" të planifikuara për SME-të nëpërmjet ridizenjimit të skemave mbështetëse.

# NGA VIJNË PARATË E BUXHETIT?

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit 2020 pritet të jenë 509,7 miliardë lekë, ose 28.4% e PBB-së dhe 4.7% më të larta se një vit më parë.

Shpenzimet gjithsej për buxhetin 2020 janë parashikuar në nivelin 549.3 miliardë lekë, ose 30.6% e PBB-së dhe 5.7% më të larta se një vit më parë.

Të ardhurat e përgjithshme

**509,7**  
miliardë lekë

OSE  
**28.4%**  
PBB

4.7% më të larta se një vit më parë


Të ardhurat e përgjithshme

**549.3**  
miliardë lekë

OSE  
**30.6%**  
PBB

2% më të larta se një vit më parë


**Grafiku 1**



**■ TOTAL I TË ARDHURAVE**


- Të ardhura nga ndihmat
- Të ardhura tatimore
- Nga tatimet dhe doganat
- Të ardhura nga pushteti vendor
- Të ardhura nga Fondet Speciale
- Të ardhura jotatimore

**Grafiku 2**



- Të ardhura nga ndihmat
- Të ardhura tatimore
- Nga tatimet dhe Doganat
- Të ardhura nga Pushteti Vendor
- Të ardhura nga Fondet Speciale
- Të ardhura jotatimore

**Grafiku 3**



- Shërbimet e Përgjithshme Publike
- Mbrojtja
- Rendi dhe Siguria Publike
- Çështjet Ekonomike
- Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit
- Mbrojtja e Mjedisit
- Shëndetësia
- Argëtimi, Kultura dhe Çështjet Fetare
- Arsimi
- Mbrojtja Sociale
- Shpëzime të tjera të paklasifikuara\*

## TRANSPORTI DHE AKSESI

Treguesit fiskalë të buxhetit të konsoliduar 2017-2022

Nr.	EMERTIMI	Faktik 2017	Në % të PBB	Faktik 2018	Në % të PBB
<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>		<b>430,397</b>	<b>28.4%</b>	<b>449,909</b>	<b>27.6%</b>
<b>I.</b>	<b>Të ardhura nga ndihmat</b>	<b>11,085</b>	<b>1.3%</b>	<b>8,164</b>	<b>0.5%</b>
	Nga të cilat: mbështetje buxhetore	2,738	0.2%	2,251	0.1%
<b>II.</b>	<b>Të ardhura tatimore</b>	<b>398,629</b>	<b>25.9%</b>	<b>419,333</b>	<b>25.7%</b>
<b>II.1</b>	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>293,386</b>	<b>18.6%</b>	<b>304,318</b>	<b>18.7%</b>
	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	139,541	9.0%	143,464	8.8%
	Tatimi mbi Fitimin	31,645	2.0%	34,461	2.1%
	Akcizat	45,105	2.9%	44,987	2.8%
	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	32,102	2.1%	36,517	2.2%
	Taksa Nacionale dhe të tjera	38,502	2.5%	38,673	2.4%
	Taksa Doganore	6,492	0.4%	6,217	0.4%
<b>II.2</b>	<b>Të ardhura nga Pushteti Vendor</b>	<b>18,447</b>	<b>1.5%</b>	<b>21,863</b>	<b>1.3%</b>
	Taksa Lokale	13,273	0.9%	16,354	1.0%
	Tatimi mbi Pasurinë (ndërtesat)	4,879	0.3%	5,192	0.3%
	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël	296	0.0%	316	0.0%
<b>II.3</b>	<b>Të ardhurat nga Fondet Speciale</b>	<b>86,795</b>	<b>5.8%</b>	<b>93,153</b>	<b>5.7%</b>
	Sigurimi Shoqëror	73,999	4.8%	79,421	4.9%
	Sigurimi Shëndetësor	11,602	0.7%	12,430	0.8%
	Të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve	1,194	0.1%	1,303	0.1%
<b>III.</b>	<b>Të ardhura jotatimore</b>	<b>20,683</b>	<b>1.2%</b>	<b>22,412</b>	<b>1.4%</b>
	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	908	0.1%	900	0.1%
	Të ardhura nga Institucionet Buxhetore	13,694	0.9%	13,934	0.9%
	Dividenti	178	0.0%	38	0.0%
	Tarifat e Shërbimeve	2,332	0.2%	2,214	0.1%
	Të tjera	3,570	0.2%	5,326	0.3%

Akti Normativ 2019	Në % të PBB	Buxheti 2020	Në % të PBB	Buxheti 2021	Në % të PBB	Buxheti 2022	Në % të PBB
486,677	28.5%	502,675	28.0%	529,826	27.8%	566,017	27.8%
15,500	0.9%	16,000	0.9%	17,000	0.9%	18,100	0.9%
2,500	0.1%	2,500	0.1%	2,500	0.1%	2,500	0.1%
448,337	26.3%	465,090	25.9%	490,816	25.8%	525,407	25.8%
323,604	19.0%	334,121	18.6%	352,644	18.5%	379,445	18.6%
151,314	8.9%	151,621	8.5%	158,731	8.3%	170,794	8.4%
33,500	2.0%	38,000	2.1%	39,812	2.1%	42,838	2.1%
48,300	2.8%	50,500	2.8%	53,440	2.8%	57,502	2.8%
41,900	2.5%	47,500	2.6%	51,970	2.7%	55,920	2.7%
41,200	2.4%	39,500	2.2%	41,287	2.2%	44,424	2.2%
7,390	0.4%	7,000	0.4%	7,404	0.4%	7,967	0.4%
25,661	1.5%	26,944	1.5%	28,426	1.5%	29,632	1.5%
18,106	1.1%	21,222	1.2%	22,389	1.2%	23,332	1.1%
6,915	0.4%	5,354	0.3%	5,648	0.3%	5,887	0.3%
640	0.0%	369	0.0%	389	0.0%	412	0.0%
99,071	5.8%	104,025	5.8%	109,746	5.8%	116,331	5.7%
84,342	4.9%	88,609	4.9%	93,538	4.9%	99,210	4.9%
13,729	0.8%	14,416	0.8%	15,209	0.8%	16,121	0.8%
1,000	0.1%	1,000	0.1%	1,000	0.1%	1,000	0.0%
22,840	1.3%	21,585	1.2%	22,010	1.2%	22,510	1.1%
600	0.0%	1,000	0.1%	1,000	0.1%	1,000	0.0%
13,830	0.8%	11,560	0.6%	12,000	0.6%	12,400	0.6%
620	0.0%	500	0.0%	500	0.0%	500	0.0%
3,080	0.2%	3,500	0.2%	3,520	0.2%	3,560	0.2%
4,710	0.3%	5,025	0.3%	4,990	0.3%	5,050	0.2%

TOTALI I SHPENZIMEVE		461,410	29.7%	476,147	29.2%
<b>I.</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>382,287</b>	<b>24.6%</b>	<b>397,345</b>	<b>24.4%</b>
<b>1</b>	<b>Personeli</b>	<b>72,642</b>	<b>4.7%</b>	<b>73,582</b>	<b>4.5%</b>
	Paga	62,581	4.0%	62,174	3.8%
	Kontributi për Sigurime Shoqërore	10,061	0.6%	10,304	0.6%
	Fondi i veçantë i pagave		0.0%		
	Politika të reja pagash		0.0%		
	Arsimi i Lartë nga të ardhurat e veta			1,103	
<b>2</b>	<b>Interesat</b>	<b>31,904</b>	<b>2.1%</b>	<b>36,513</b>	<b>2.2%</b>
	Të Brendshme	21,415	1.4%	23,158	1.4%
	Të Huaja	10,489	0.7%	13,355	0.8%
	Kontingjencë për risqet e borxhit		0.0%		
<b>3</b>	<b>Shpenzime Operative Mirëmbajtje nga të cilat:</b>	<b>43,441</b>	<b>2.8%</b>	<b>45,498</b>	<b>2.8%</b>
	Të qeverisjes qëndrore		0.0%		0.0%
	Arsimi i Lartë nga të ardhurat e veta		0.0%		0.0%
	Të tjera jashtë limitit		0.0%		0.0%
<b>4</b>	<b>Subvencionet</b>	<b>2,310</b>	<b>0.1%</b>	<b>1,883</b>	<b>0.1%</b>
<b>5</b>	<b>Shpenzime për Fondet Speciale</b>	<b>162,145</b>	<b>10.5%</b>	<b>168,249</b>	<b>10.3%</b>
	Sigurime Shoqërore	119,081	7.7%	125,364	7.7%
	Politika të reja pensionesh		0.0%		0.0%
	Bonusi i Pensionistëve				
	Sigurime Shëndetësore	39,090	2.5%	40,154	2.5%
	Shpenzime për Kompensimin në Vlerë të Pronarëve	3,974	0.3%	2,731	0.2%
<b>6</b>	<b>Shpenzime për Buxhetin Vendor</b>	<b>46,487</b>	<b>3.0%</b>	<b>49,615</b>	<b>3.0%</b>
	Transfertat nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor	28,039	1.8%	27,753	0.0%
	Transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme		0.0%		
	Transfertë e pakushtëzuar sektoriale (Grant Specifik)		0.0%		
	Buxheti vendor (të ardhurat e veta tatimore)	18,447	1.2%	21,863	1.3%
	Taksa të ndara		0.0%		0.0%
	Buxheti vendor (të ardhurat e veta jo-tatimore)		0.0%		0.0%
	Financimi i huaj vendor				

519,577	30.5%	531,974	29.7%	554,858	29.1%	588,722	28.9%
<b>428,719</b>	<b>25.1%</b>	<b>446,433</b>	<b>24.9%</b>	<b>464,534</b>	<b>24.4%</b>	<b>490,521</b>	<b>24.1%</b>
<b>80,557</b>	<b>4.7%</b>	<b>83,856</b>	<b>4.7%</b>	<b>84,273</b>	<b>4.4%</b>	<b>88,473</b>	<b>4.3%</b>
65,651	3.8%	70,994	4.0%	71,209	3.7%	71,509	3.5%
11,006	0.6%	11,562	0.6%	11,664	0.6%	12,464	0.6%
400	0.0%	300	0.0%	400	0.0%	500	0.0%
2,000	0.1%	0	0.0%	0	0.0%	3,000	0.1%
1,500	0.1%	1,000	0.1%	1,000	0.1%	1,000	0.0%
<b>40,100</b>	<b>2.4%</b>	<b>40,950</b>	<b>2.3%</b>	<b>45,509</b>	<b>2.4%</b>	<b>49,664</b>	<b>2.4%</b>
23,100	1.4%	23,500	1.3%	26,809	1.4%	29,764	1.5%
12,700	0.7%	13,450	0.7%	13,700	0.7%	13,900	0.7%
4,300	0.3%	4,000	0.2%	5,000	0.3%	6,000	0.3%
<b>48,019</b>	<b>2.8%</b>	<b>50,021</b>	<b>2.8%</b>	<b>52,548</b>	<b>2.8%</b>	<b>55,498</b>	<b>2.7%</b>
44,019	2.6%	46,721	2.6%	49,148	2.6%	52,048	2.6%
1,900	0.1%	1,000	0.1%	1,100	0.1%	1,100	0.1%
2,100	0.1%	2,300	0.1%	2,300	0.1%	2,350	0.1%
<b>1,430</b>	<b>0.1%</b>	<b>1,290</b>	<b>0.1%</b>	<b>1,490</b>	<b>0.1%</b>	<b>1,490</b>	<b>0.1%</b>
<b>178,987</b>	<b>10.5%</b>	<b>188,588</b>	<b>10.5%</b>	<b>195,891</b>	<b>10.3%</b>	<b>208,391</b>	<b>10.2%</b>
129,637	7.6%	137,468	7.7%	142,965	7.5%	151,465	7.4%
2,450	0.1%	2,520	0.1%	2,620	0.1%	3,120	0.2%
41,900	2.5%	44,100	2.5%	45,306	2.4%	48,306	2.4%
5,000	0.3%	4,500	0.3%	5,000	0.3%	5,500	0.3%
<b>55,286</b>	<b>3.2%</b>	<b>57,128</b>	<b>3.2%</b>	<b>59,923</b>	<b>3.1%</b>	<b>61,756</b>	<b>3.0%</b>
25,075	1.5%	25,614	1.4%	26,697	1.4%	28,274	1.4%
17,632	1.0%	18,000	1.0%	19,050	1.0%	20,390	1.0%
7,443	0.4%	7,614	0.4%	7,647	0.4%	7,884	0.4%
25,661	1.5%	26,944	1.5%	28,426	1.5%	29,632	1.5%
650	0.0%	670	0.0%	700	0.0%	750	0.0%
2,900	0.2%	2,900	0.2%	3,100	0.2%	3,100	0.2%
1,000	0.1%	1,000	0.1%	1,000	0.1%	0	

<b>7</b>	<b>Shpenzime të tjera</b>	<b>23,357</b>	<b>1.5%</b>	<b>22,004</b>	<b>1.3%</b>
	Pagesa e Papunësisë	346	0.0%	336	0.0%
	Ndihma Ekonomike dhe Paaftësia	20,714	1.3%	20,671	1.3%
	Kompensim për ish të perndjekurit politike	2,298	0.1%	997	0.1%
	Shpërblymi i familjeve në nevojë				
	Bonusi i lindjeve				
<b>II.</b>	<b>Fondi Rezervë</b>	<b>0</b>	<b>0.0%</b>	<b>0</b>	<b>0.0%</b>
	Fondi Rezervë		0.0%		0.0%
	Rezervë për reformën në Drejtësi		0.0%		0.0%
<b>III.</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>68,455</b>	<b>4.4%</b>	<b>78,434</b>	<b>4.8%</b>
	Financim i Brendshëm	46,177	3.0%	51,552	3.2%
	Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë		0.0%	672	
	Financim i Huaj	22,278	1.4%	26,210	1.6%
	nga të cilat: Energjia				
<b>V</b>	<b>Të tjera</b>	<b>9,217</b>	<b>0.6%</b>	<b>368</b>	<b>0.0%</b>
	Hua e dhënë për Energjinë	9,217	0.6%		
	Hua e kthyer nga sistemi energjitik				
	Transferime kapitale			368	0.0%
<b>VI</b>	<b>Fond Shpronësimi</b>	<b>1,450</b>	<b>0.1%</b>		
	<b>DEFIÇITIT</b>	<b>-31,012</b>	<b>-2.0%</b>	<b>-26,238</b>	<b>-1.6%</b>
	<b>FINANCIMI DEFIÇITIT</b>	<b>31,012</b>	<b>2.0%</b>	<b>26,238</b>	<b>1.6%</b>
	<b>Brendshëm</b>	<b>1,899</b>	<b>0.1%</b>	<b>-6,866</b>	<b>-0.4%</b>
	Të ardhura nga privatizimi	418	0.0%	104	0.0%
	Hua-marrje e brendshme	16,285	1.0%	19,591	1.2%
	Të tjera	-14,804		-26,561	
	<b>I Huaj</b>	<b>29,113</b>	<b>1.9%</b>	<b>33,104</b>	<b>2.0%</b>
	Hua afatgjatë (e marrë)	23,407	1.5%	83,761	5.1%
	Ndryshimi i gjendjes së arkës	169	0.0%	106	0.0%
	Ripagesat	-25,769	-1.7%	-51,678	-3.2%
	Mbështetje buxhetore	31,306	2.0%	916	0.1%
	<b>Produkti i Brendshëm Bruto (PBB)</b>	<b>1,551,281</b>	<b>100%</b>	<b>1,630,905</b>	<b>100%</b>



		600	601	602	603
Funksioni		Pagat	Kontrib.e Sigurimeve Shoqërore	Mallra dhe Shërbime	Subveconet
01	Shërbimet e përgjithshme publike	13,602,811	2,212,575	11,274,249	200,000
02	Mbrojtja	4,933,600	818,000	6,085,145	0
03	Rendi dhe siguria publike	20,251,565	3,172,127	4,723,508	0
04	Çështjet ekonomike	2,847,103	485,771	3,633,950	400,000
05	Mbrojtja e mjedisit	436,760	73,320	119,920	0
06	Strehimi dhe komoditetet e komunitetit	67,300	11,400	225,900	300,000
07	Shëndetësia	2,795,800	476,600	2,326,890	0
08	Argëtimi, kultura dhe çështjet fetare	830,037	136,363	294,092	0
09	Arsimi	24,252,735	4,009,446	1,982,592	0
10	Mbrojtja sociale	976,442	166,406	578,762	390,000
Shpenzime të tjera të paklasifikuara*					
<b>Totali</b>		<b>70,994,153</b>	<b>11,562,008</b>	<b>31,245,008</b>	<b>1,290,000</b>
Shërbimet e përgjithshme publike				38,714,326	
Mbrojtja				15,799,995	
Rendi dhe siguria publike				30,717,857	
Çështjet ekonomike				40,815,859	
Mbrojtja e mjedisit				1,197,000	
Strehimi dhe komoditetet e komunitetit				28,902,193	
Shëndetësia				52,833,898	
Argëtimi, kultura dhe çështjet fetare				3,419,844	
Arsimi				45,054,282	
Mbrojtja sociale				163,595,038	
Shpenzime te tjera te paklasifikuara*				128,323,650	
Totali				549,373,942	

604	605	606	230	231	Totali
Të tjera Transferta Korrente të Brendshme	Transferta Korrente të Huaja	Transferta për Buxhetet Familiare dhe Individët	Shpenzime Kapitale të Patrupëzuara	Shpenzime Kapitale të Trupëzuara	2017
4,813,574	1,036,139	1,249,350	435,938	4,744,190	39,568,826
0	0	352,500	0	4,630,000	16,819,245
13,500	13,000	463,500	4,720	2,372,373	31,014,293
66,625	14,300	844,640	659,683	32,020,649	40,972,721
7,000	0	0	5,000	678,000	1,320,000
0	0	309,000	255,903	27,179,780	28,349,283
44,099,818	400,000	2,000	14,000	2,999,972	53,115,080
1,145,020	57,889	0	20,000	1,261,723	3,745,124
9,087,340	70,000	896,200	26,732	5,107,637	45,432,682
137,598,478	4,000	23,600,000	2,000	222,700	163,538,788
					108097650
<b>196,831,355</b>	<b>1,595,328</b>	<b>27,717,190</b>	<b>1,423,976</b>	<b>81,217,024</b>	<b>531,973,692</b>

\* Në zërin "Shpenzime të tjera të paklasifikuara" (Totali) janë përfshirë:

- (i) pagesat për shërbimin e borxhit,
- (ii) kontigjenca për politika pagash dhe pensionesh,
- (iii) fondi rezervë, dhe (iv) shpenzimet e pushtetit vendor

\*\* Shpenzimet e pushtetit vendor nuk janë shpërndarë sipas funksioneve pasi ndarja e tyre është kompetencë e këtij pushteti







REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

